



**KËSHILLI PËR DEMOKRACI DHE TË DREJTA TË NJERIUT
COUNCIL FOR DEMOCRACY AND HUMAN RIGHTS
SAVET ZA DEMOKRATIJU I LJUDSKA PRAVA**

Këshilli për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, në takimin e mbajtur më 2 dhjetor 2022, nxori si përfundim, rekomandime konkrete mbi çështjet e mëposhtme në lidhje me dhunën mbi bazë gjinore:

a. Parandalimi

- Krijimi apo përsheptimi i rishikimit të procedurave të veçanta në Polici, Prokurori, Gjykata, institucione të mbrojtjes së viktimave dhe ato për punëtorët social për t'u marrë me dhunën në familje, dhunën mbi bazë gjinore dhe dhunën seksuale (duke qenë të vetëdijshëm se këto tri forma të krimeve mbi bazë gjinore, janë të ndërlidhura). Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - Zbatimi i Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave;
 - Caktimin e koordinatorëve për dhunë në familje dhe dhunë ndaj grave dhe vajzave në prokuroritë themelore;
 - Zbatimi i kurrikulës për trajtimin e dhunuesve në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave;
- Trajnimet e avancuara dhe të specializuara të pjesëtarëve të Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave, që merren me raste të dhunës mbi bazë gjinore;
- Rritja e kapaciteteve logjistike të Policisë së Kosovës për ekipet e monitorimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës mbi bazë gjinore, duke përfshirë, themelimin e njësiveve relevante në raste kur mungojnë;
- Viktimave të dhunës t'u ofrohet ndihma juridike falas pavarësisht gjendjes socio-ekonomike dhe njëkohësisht, të ngritet bashkëpunimi në mënyrë që të njoftohen viktimat me mundësinë ekzistuese për ndihmë juridike falas;
- Të eliminohen procedurat burokratike për kompensim të viktimave ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi;
- Vazhdimi i takimeve të rregullta të Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut dhe Grupit Ndërministror për adresimin e dhunës mbi bazë gjinore;
- Modul i veçantë për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, me fokus të veçantë në çështjet që ndërlidhen me dhunën mbi bazë gjinore. Ky modul të ligjërohet në shkollimin parauniversitar;

- Rishikimi i teksteve shkollore në frymën e barazisë gjinore dhe eliminimin e të gjithë përmbajtjes e cila shkon në kundërshtim me vlerën e barazisë gjinore;
- Nxjerrja e akteve nënligjore që siguron se të gjitha institucionet arsimore, të të gjitha niveleve, nxjerrin akte normative të brendshme për parandalimin dhe raportimin e ngacmimeve seksuale;
- Rritja e numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkolla;
- Rritja e kapaciteteve të inspektoratit të arsimit;
- Ndarja e mjeteve adekuate buxhetore për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave;
- Hartimi i politikave të veçanta sektoriale për ngacmime seksuale edhe për sektorin privat, përfshirë atyre për ndalimin e ngacmimeve seksuale, por edhe protokolleve për raportim të ngacmimeve në atë sektor dhe trajnimeve të detyrueshme për to;
- Ngritja e nivelit të organizimit funksional nga sektori i dhunës në familje në Drejtori në kuadër të Policisë së Kosovës;
- Vazhdimi i ndërtimit të “dhomave mike” për viktimat e dhunës në familje në kuadër të Policisë së Kosovës;
- Krijimi i një mekanizmi adekuat, në bashkëpunim me sektorin e TIK, OJQ-të dhe mediat me qëllim të veprimit konkret në lidhje me gjuhën seksiste dhe dhunën e shprehur në rrjete sociale;
- Fushatat publike vetëdijesuese kundër dhunës mbi bazë gjinore duke targetuar audiencë specifike shoqërore;
- Ofrimi i ekspertizës për Projektligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave;
- Plotësimi i procedurave standarde të veprimit dhe harmonizimi i plotë i tyre me ndryshimet ligjore, siç janë ndryshimet në Kodin Penal dhe ato kushtetuese përkitazi me përfshirjen e Konventës së Stambollit, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Po ashtu, rishikimi i procedurave standarde të veprimit pas miratimit të legjislacionit përkatës;
- Të bëhet licencimi i institucioneve shëndetësore publike, me ç’rast do të standardizoheshin edhe praktikat e reagimit ndaj kërkesave të qytetarëve;
- Ndarja e buxhetit të nevojshëm për zbatimin e Ligjit për Mbikëqyrje Elektronike;
- Vendosja e byzylykut sinjalizues për lëvizjet fizike të personave të denoncuar për dhunë ndaj grave dhe dhunë në familje;
- Rritja e sigurisë në institucionet publike shëndetësore;
- Rishikimi i legjislacionit përkatës që ka të bëjë me parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga dhuna me bazë gjinore;
- Rishikim i zbatimit të Protokollit për Parandalimin dhe Referim të Dhunës në Shkolla përmes grupit ndërinstitucional të udhëhequr nga MASHTI.

b. Bashkërendimi ndër-institucional

- Krijimi apo rishikimi i protokolleve të veçanta të bashkërendimit në mes të Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe Qendrave për Strehimin e viktimave të dhunës mbi bazë gjinore.
- Këto linja dhe protokolle duhet të përfshijnë edhe sektorin e shëndetësisë për të normuar reagimin dhe raportimin e punëtorëve të shëndetësisë për dyshimet për dhunime dhe dhunës në familje. Kjo mund të realizohet përmes implementimit të Kujdesit të Integruar Shëndetësor i cili përfshinë shërbimet e kujdesit fizik, psikik dhe financiar për viktimën;
- Emërimi i zyrtarëve përgjegjës në Policinë e Kosovës për komunikim dhe bashkëpunim të rregullt me MASHT-in, përfaqësues të SHSKUK-së ose spitaleve të tjera regjionale, organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të komunave, lidhur me raportimet e ngacmimeve seksuale dhe dhunës mbi bazë gjinore;
- Krijimi i një task force në MASHT-i (me pjesëmarrje edhe të përfaqësuesve të Këshillave të Prindërve dhe Qendrave për Punë Sociale), për luftimin e ngacmimeve seksuale në shkolla;
- Bashkëpunim i drejtpërdrejt i Policisë së Kosovës me mekanizmat lokal për siguri në bashkësi dhe forcimi i Policisë në Bashkësi;
- Krijimi i mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në nivele komunale dhe të udhëhequra nga kryetarët e komunave;
 - Takime të rregullta me kryetarët e komunave;
- Përdorimi i pajisjeve inçizuese nga policia e Kosovës gjatë marrjes së deklaratës fillestare të viktimave, për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi. Këto inçizime të ruhen në një server të mbrojtur dhe të centralizuar. Po ashtu, rekomandohet të sigurohet prezenca e psikologëve gjatë marrjes së deklaratës fillestare.

c. Politikat ndëshkimore

- Shqiptimi më i shpeshtë i masës së paraqitjes në stacionin policor, arrestit shtëpiak dhe bastisjes, nga gjykatat ndaj personave të dyshuar për dhunë në familje apo dhunë mbi bazë gjinore;
- Plotësim Ndryshimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, duke përfshirë krijimin e bazës ligjore që hetimet dhe gjykimet për veprat e dhunës mbi bazë gjinore të mos zgjasin më shumë se një vit, publikimin e emrave të dhunuesve dhe masave tjera ndëshkimore;
- Rishikimi/plotësimi i udhëzuesit për matjen e dënimeve në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës mbi bazë gjinore;
- Hartimi i një raporti/analize që i identifikon trendet e ndërlidhura me këto fenomene nga Policia e Kosovës, KPK-ja dhe KGJK-ja për të gjitha rastet penale të veprave të dhunës mbi bazë gjinore;

- Ashpërsimi i procedurave disiplinore dhe të tjera ndaj zyrtarëve të Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave, që nuk veprojnë në mënyrë të duhur në rastet e dhunës mbi bazë gjinore.

d. Ndhurma ndaj viktimave

- Krijimi i një task force apo ekipi të specializuar (psikolog, mjek, pedagog) për të ndihmuar rehabilitimin e menjëhershëm dhe afatgjatë të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës mbi bazë gjinore;
- Fuqizimi i Qendrave për Punë Sociale: rritja e numrit të të punësuarve, ngritja e kapaciteteve aktuale të tyre, garantimi i mbështetjes së nevojshme buxhetore;
- Të garantohet, në nivele komunale, banimi social për të mbijetuarat e dhunës. Në pamundësi të banesave sociale të aplikohet praktika e ‘bonus banimit’ e garantuar me legjislacion, ku komuna paguan qiranë e viktimës;
- Rritja e buxhetit për subvencionimin e OJQ-ve që merren me mbrojtjen e të drejtave të grave, nga të gjitha institucionet relevante;
- Ndhimë të vazhdueshme (mujore) financiare për gratë dhe fëmijët – viktima të dhunës në familje;
- Shërbime të vazhdueshme mjekësore për gratë dhe fëmijët – viktima të dhunës në familje dhe dhunës mbi baza gjinore;
- Krijimi i një fondi brenda Policisë së Kosovës (para arke) i cili do të shërbente për mbështetje të viktimës të paktën në 48 orët e para;
- Përdorimi i rrëfimeve të viktimave në lidhje me ndikimin e ngjarjeve në jetën e tyre për të ndikuar në informim dhe ndjeshmëri të publikut.